



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 06/04/23 Ref.: 437/23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 110-të mbajtur me 28.03.2023, mori:

V E N D I M

- I. **Akreditohen** programet e studimeve të Universitetit të Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, për periudhën pesë (5) vjeçare, duke filluar nga 1 tetor 2023 deri me 30 shtator 2028:
 1. *Komunikacion dhe Transport, BSc 180 ECTS, maksimum 80 studentë për vit akademik.*
 2. *Dizajn Inxhinierik dhe Automjete, BSc 180 ECTS, maksimum 70 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike që deri më datë 01 tetor 2023 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programit të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

1/2

Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim për riakreditim të programeve të studimeve me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Komunikacion dhe Transport, BSc 180 ECTS,</i> Riakreditim	Ramadan Duraku Arlinda Rrecaj Gëzim Hoxha
2.	<i>Dizajn Inxhinierik dhe Automjete, BSc 180 ECTS</i> Riakreditim	Naser Lajqi Halil Demolli Beqir Hamidi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA me datë 15.02.2023 ka organizuar vizitë në Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit Andreas Mehrle dhe Matej Drobnic.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit të programit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Komunikacion dhe Transport, BSc 180 ECTS*, Riakreditim nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) dhe substancialisht pesë (5) dhe standarde.
2. Për programin e studimit *Dizajn Inxhinierik dhe Automjete, BSc 180 ECTS*, Riakreditim, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2), substancialisht katër (4) dhe pjesërisht një (1) standard.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 110 ka shqyrtuar aplikacionin e Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hashija Hazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror



Cilësisë